02/Nr. Prot. 20 180/1922
Nr. i faq. 2
Data 10/03/2020

**REPUBLIKA E KOSOVËS/** REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA
**KOMUNA E JUNIKUT/** MUNICIPALITY OF JUNIK - OPŠTINA JUNIK

**Republika e Kosovës;**
**Kuvendi i Komunës së Junikut;**
**Numër: 02/02/ 2020;**
**Datë: 09.03.2020 .**

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 22 paragrafi 22.1 pika 4) të Statutit të Komunës së Junikut dhe nenit 8 paragrafi 8.1. të Rregullores mbi transparencën, **Kuvendi i Komunës së Junikut** në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur më 28.02.2020 nxjerrë:

# VENDIM

**për hapjen e diskutimit publik për** miratimin e Planit Komunal për ri integrim të qëndrueshëm të përsonave të riatdhesuar ;

**I.** Me këtë vendim **hapet diskutimi publik** për miratimin e Planit Komunal për ri integrim të qëndrueshëm të përsonave të riatdhesuar /në tekstin e mëtejmë Plani/.

**II.** Plani nga pika I. e këtij vendimi vihen në dispozicion të publikut për shqyrtim publik dhe komente.

**III.** Të gjitha propozimet dhe vërejtjet që paraqiten nga publiku brenda afatit kohor prej 15 ditëve do të përfshihen në raportin e shqyrtimit publik.

**IV.** Ekspozimi i Planit do të bëhet në zyrën 7 të objektit të Komunës së Junikut.

**V.** Diskutimi publik i Planit zgjat 15 ditë (fillon më: 06.03.2020 dhe përfundon më: 23.03.2020).

**VI.** Gjatë kohës së diskutimit publik projekt Plani ekspozohet edhe në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut për shqyrtim dhe komente.

**VII.** Diskutimi publik i Planit organizohet nga Komuna e Junikut respektivisht Zyra e Kryetarit të Komunës së Junikut.

**VIII.** Organizatori është i obliguar që të hartojë planin e veprimit dhe organizimit të aktiviteteve gjatë kohës së diskutimit publik të këtijj Plani.

**IX.** Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset kryetari i Komunës së Junikut respektivisht Zyra e Kryetarit të Komunës.

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohen të gjitha vendimet e mëparshme me anën e të cilave kjo fushë ka qenë e rregulluar.

XI. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut.

Me këtë vendim njoftohen:

1. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal;
2. Kryetari i Komunës së Junikut;
3. Shërbimi i Kuvendit të Komunës së Junikut; dhe
4. Arkivi i Komunës së Junikut.

Kryesuesi i Kuvendit
z. Muharrem Krasniqi